



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES

**RAPORT**  
**PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E**  
**MBROJTJES PËR VITIN 2023**

**1.Përmbledhja ekzekutive** *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Gjatë vitit 2023, Ministria e Mbrojtjes ka realizuar procesin e konsultimit publik të akteve të miratuara, objekt i ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Konkretisht janë konsultuar nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (këtu e në vijim RENjKP) dhe aktiviteteteve të tjera konsultative:

1. Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”;
2. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030”;
3. Projektvendimi “Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në Shqipëri”;
4. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave të ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Është zgjedhur që grupeve të interesit t’i drejtohem në rrugë elektronike dhe në raste të tjera janë organizuar takime grupi pune.

Në tërësi ka pasur një rritje të numrit të personave të përfshirë në konsultim nëpërmjet dhënies së mendimeve/sugjerimeve. Ky fakt ka ndikuar në cilësinë e procesit të draftimit të projektakteve pasi shpeshherë sugjerimet e marra nga grupet e interesit kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin e draftit të projektaktit.

**2.Analiza e konsultimeve të kryera**

***2.1.Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike***

Sipas Nenit 1 të ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe konsultimin publik”, vetëm 4 nga aktet e miratuara duhet t’i nënshtrohen procesit të konsultimit publik, të cilat janë konsultuar gjatë vitit 2023.

### ***2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?***

Numri total i akteve të miratuara për vitin 2023 është 17 projektvendime dhe 1 projektligj.

### ***2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?***

Akte objekt konsultimi për vitin 2023 janë planifikuar 8 (tetë), nga të cilat 4 (katër) akte janë miratuar për vitin 2023, të cilat i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik. Në lidhje me pjesën tjetër të akteve të cilat janë miratuar, nuk kanë qenë objekt i konsultimit publik në përputhje me parashikimet e ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

### ***2.1.2. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?***

Asnjë prej akteve të konsultuara nuk ishin objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45 të Rregullores së Këshillit të Ministrave.

### ***2.1.3. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyt kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?***

Në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projektdokumentet strategjike kombëtare dhe vendore, dhe për pasojë nga ana jonë konsultimi publik është parashikuar të realizohet vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t'iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1 të këtij ligji. Në nenin 4 të ligjit "Për njoftimin dhe konsultimin publik" është parashikuar lista e projektakteve që nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, siç janë çështjet e sigurisë kombëtare që përbëjnë sekret shtetëror, marrëveshjet ndërkombëtare, aktet normative të KM me fuqinë e ligjit, emergjenca civile dhe çështje të tjera të parashikuara me ligj.

Nga 11 projektakte, të cilat janë në përputhje me PKIE, Programin Analitik dhe Dokumentet Strategjike, për 4 projektakte janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike.

- Projektvendimi "Për pjesëmarrjen e FARSH në operacionet e NATO-s" FOCOPS" - mision
- Projektvendimi "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.392/2021 "Për specialitetet në FA"- akt me karakter individual.

- Projektvendimi "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.574/2021 "Për një ndryshim në vendimin 475/2017 "Për pjesëmarrjen e një toge të F.A.R.SH, në operacionin ushtarak të NATO-s, në Letoni", të ndryshuar - mision
- Projektvendimi "Për pjesëmarrjen e FARSH në operacionet e NATO-s" AEGEAN SEA" - mision

#### **2.1.4. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?**

Aktet e miratuara objekt i konsultimit publik gjatë vitit 2023 janë 3 (tre) projektvendime dhe 1 (një) projektligj.

#### **2.1.5. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?**

Krahasuar me një vit më parë, në këtë vit vihet re një numër më i madh akteve të parashikuara të konsultuara, të cilat janë konsultuar si nëpërmjet regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin (RENJK), ashtu edhe nëpërmjet takimeve konsultative me grupet e interesit. Krahasuar me vitin e kaluar kemi një organizim më të madh të takimeve konsultative fizikisht, të zhvilluara në të dyja fazat: si në fazën paraprake ashtu edhe në fazën e konsultimit publik, referuar lehtësimit të masave shtrënguese.

### **2.2. Metodatat e konsultimit**

#### **2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)**

Për të zhvilluar konsultimet publike mbi projektaktet që do të propozohen për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, nga ana jonë u përdoren këto metoda:

- i) Publikimi i draftit të projektligjit në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit;
- ii) Publikimi i draftit në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes (të gjitha komentet/sugjerimet mund të dërgohen në adresën e emailit të hapur për këtë qëllim: [konsultimi.publik@mod.gov.al](mailto:konsultimi.publik@mod.gov.al));
- iii) Zhvillimi i takimeve publike me grupet e interesit.

#### **2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?**

Metoda e cila gjeneroi më shumë komente ishte nëpërmjet zhvillimit të takimeve publike me grupet e interesit, partnerë dhe organizata ndërkombëtare, sektorin privat dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Publikimi në regjistrin elektronik të konsultimit publik ka qenë i frytshëm sepse

ka mundësuar që të interesuarit të shohin aktet, por nuk ka gjeneruar komente. Komentet janë mbledhur nga metoda e takimeve konsultative.

### ***2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?***

Po, Ministria e Mbrojtjes organizoi takime paraprake për të gjitha aktet e konsultuara, me grupet e interesit, konkretisht strukturat dhe institucionet në varësi të tij për të diskutuar të gjitha projektaktet përpara se të fillonte me hartimin e draftit.

## ***2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve***

### ***2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?***

Për të gjitha aktet objekt shqyrtimi të procesit të konsultimit publik, është kryer publikimi në RENJK, duke respektuar afatin ligjor prej 20 ditë pune. Për sa i përket konsultimeve nëpërmjet metodave të tjera, ato janë zhvilluar për një periudhë më të gjatë, duke përfshirë disa muaj, për shkak të kompleksitetit dhe rëndësisë të secilit akt.

### ***2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?***

Konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) për të gjitha aktet e planifikuara gjatë vitit 2023, u realizua në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij. Konsultimet patën një kohëzgjatje prej 20 ditë pune duke filluar nga data e publikimit.

Kurse kohëzgjatja mesatare e projektakteve të konsultuara nëpërmjet të gjitha metodave të konsultimit, duke përfshirë dhe konsultimin paraprak, ka qenë afërsisht 1 muaj.

### ***2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?***

Situata këtë vit është përmirësuar, kjo sepse ka pasur një angazhim më të madh të rolit të koordinatorit të procesit të konsultimit publik për Ministrinë e Mbrojtjes, kjo dhe si rezultat i trajnimeve të zhvilluara, të cilat kanë ndikuar në të kuptuarit më mirë të rëndësisë dhe në menaxhimin më të mirë të këtij procesi, si dhe në bashkëpunimin me efektiv me strukturat teknike hartuese të akteve, të cilat kanë pasur më të lehtë identifikimin e grupeve të interesit të përfshira në dhënien e kontributit të tyre.

Numri i projektakteve të publikuara këtë vit është në rritje, duke arritur 7 (shtatë) projektakte, në ndryshim nga viti 2022, 2 (dy) projektakte.

#### ***2.4. Palët e interesuara të përfshira***

##### ***2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?***

Kryesisht, në grupet e punës për hartimin e akteve kanë marrë pjesë personeli i Ministrisë së Mbrojtjes dhe strukturat në varësi të saj dhe 10 (dhjetë) aktorë të jashtëm për hartimin e projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030” dhe 15 aktorë të jashtëm për projektvendimin “Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror”. Pavarësisht kësaj, për projektaktet që kanë impakt të drejtpërdrejtë tek grupet e interesit jashtë Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë organizuar takime publike.

##### ***2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)***

Në hartimin e këtyre projektakteve kanë marrë pjesë vetëm grupe interesi brenda Ministrisë së Mbrojtjes Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe strukturave në varësi të tyre.

Në hartimin e projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030” dhe projektvendimit “Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror” kanë marrë pjesë organizata të shoqërisë civile, biznese, komunitete të biznesit, ambasada, universitete, njësi të qeverisjes vendore.

##### ***2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?***

Projektaktet të cilat janë hedhur për konsultim publik në RENJKP nuk kanë patur komente nga publiku. Aktet janë konsultuar me ministrinë e linjës, ku janë gjeneruar dhe komente.

Në hartimin e projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030” dhe projektvendimit “Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror” kanë marrë pjesë organizata të shoqërisë civile, biznese, komunitete të biznesit, ambasada, universitete, njësi të qeverisjes vendore.

##### ***2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?***

Aktet i janë nënshtruar konsultimit publik nëpërmjet mbledhjeve të zhvilluara me anëtarët e grupit të punës, me pjesëmarrjen e SHPPFA dhe strukturave në varësi të tyre.

Aktet i janë nënshtruar konsultimit publik nëpërmjet mbledhjeve të zhvilluara me anëtarët e grupit të punës, me pjesëmarrjen e AKMC dhe bashkive të vendit.

- Kontribues për Riskun Teknologjik për projektvendimin “Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror” me të cilët janë zhvilluar takime janë:

1. Shoqëria “La Petrolifera Italo Rumena” sh.a. (PIA), Vlorë;
2. Shoqëria TEC Vlora” sh.a;
3. Shoqëria “ALBPETROL” sh.a Patos;
4. Shoqëria “Bankers Petroleum” Ltd, Fier;
5. Në Stacionin e Kompresorëve të Gazsjellësit Trans Adriatik (kompania TAP AG), në Seman, Fier;
6. Në Impiantin e Furnizimit me Ujë të Bovillës, në administrim të Ndërmarrjes së Ujësjetllësit Tiranë, Impiantit të Trajtitimit të Ujit të Bovillës, në Paskuqan, si dhe në liqenin e Bovillës, Ndërmarrja e Ujësjetllësit Tiranë;
7. Në Fabrikën e prodhimit të Vajit të Lulediellit “Olim”, Tiranë, me teknologun e “OLIM”;
8. Në Portin e Hidrokarbureve “Porto Romano” në administrim të shoqërisë koncesionare “Romano Port” sh.a. në Porto Romano, Durrës;
9. Në Fabrikën e Pasurimit të Kromit sh.p.k., Bulqizë.

- Kontribues për Sëmundjet Infektive (Epidemi, Pandemi, etj.) me të cilët janë zhvilluar takime janë:

1. Takim në Portin e Durrësit, për protokollet e pranimit të udhëtarëve dhe trajtimit të rasteve;
2. Takim me strukturat e aeroportit të Rinasit, gjithashtu për vlerësimin e protokollove të udhëtarëve;
3. Takim në Kompanitë Erzeni dhe Lufra, për procedurat standarde të përpunimit dhe prodhimit.

- Kontribues për Zjarret në Pyje me të cilët janë zhvilluar takime janë:

1. takim në ambientet e UNDP me përfaqësuesin e projektit JICA, lidhur me ngritjen e një sistemi të paralajmërimit të hershëm për zjarret në Shqipëri;
2. takim në Universitetin Epoka;
3. takim në Ambasadën Suedeze me qëllim informues;
4. takim me palët e interesuara vendore në ambientet e Prefekturës së Qarkut Kukës.

- Kontribuues për përmbytjet nga lumenjtë, përrrenjtë dhe çarjet e digave me të cilët janë zhvilluar takime janë:

1. vizitë me përfaqësues të mbrojtjes civile në institucionet lokale përgjegjëse për hartimin e Planit të Emergjencave në Bashki;

2. zhvilluar takime në terren në Qarkun e Tiranës, Durrësit, Beratit, Kukësit, Vlorës, dhe Elbasanit.

Sa i përket projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030”, në takimin me Grupet e interesit morën pjesë 20 përfaqësues të listuar si më poshtë vijon:

1. Kryeministria, Znj. Esmeralda Hasani;
2. Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Z. Ilir Ciko;
3. Delegacioni i BE, Z. Hubert Grandjean;
4. Banka e Shqipërisë, Z. Elton Lloji
5. Eorl Bank, Z. Keler Gjika;
6. GIZ, Znj. Rezarta Ago;
7. UNICEF, Znj. Mariana Bukli;
8. Sëeden Embasy, Znj. Linda Gjermani;
9. Austrian Embasy (ADA), Znj. Ada Bedini ;
10. USAID, Znj. Alma Kospiri
11. Organizata e Kryqit të Kuq Shqiptar, Z. Fatos Xhengo;
12. Fondacioni Eorl Vizion, Z. Endri Teta ;
13. UN Eoman, Znj. Irena Shtraza;
14. FAO Shqipëri, Z. Agim Pepkoli ;
15. Shoqëri Civile, Znj. Ari Dyrmishi;
16. Fondacioni CIMA, Znj. Miranda Deda;
17. French Development Agency, Znj. Silvamina Alshabani;
18. Sektori Privat- GBI Health and Safety Academy, Z. Ervin Dervishi dhe Ledian Bregu;
19. REC Albania, Z. Mihallaq Qirjo;
20. Shoqata Shqiptare për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin – AFPRA, Z. Alban Laçi.

#### ***2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?***

Në krahasim me vitin e kaluar situata nuk ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik vijon të jetë ende i ulët për akte të caktuara.

### ***2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra***

#### ***2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?***

93 komente janë mbledhur nga takimet konsultative. Nga konsultimi përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, nuk ka pasur komente për aktet e publikuara dhe të konsultuara sipas kësaj metode. Pjesa më e madhe e komenteve janë përcjellë përmes konsultimit me ministrinë e linjës nëpërmjet sistemit të e-Aktet.

### 2.5.2. *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

- Komentet për projektvendimin “Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror” janë marrë në konsideratë, trajtuar, refuzuar apo reflektuar rast pas rasti, sipas takimeve të zhvilluara me grupet e interesit, gjatë procesit të hartimit të dokumentit të Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror, konkretisht, janë pranuar 38 komente, 5 komente janë pranuar pjesërisht, 4 janë refuzuar;
- Për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe planit të veprimit, janë pranuar plotësisht 28 komente, 6 janë pranuar pjesërisht, 12 janë refuzuar.

*Grafik1: shkalla e pranimit të reagimeve të mbledhura.*



### 2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Krahasuar me vitet e kaluara, ku takimet publike ishin metoda që gjeneronte numrin më të madh të komenteve, kjo periudhë nuk ishte në një gjendje të kënaqshme, duke qenë se përfshirja e publikut nuk ishte në nivelin ndikues.

### 2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Raporti i VNR për projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave të ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, nuk është përditësuar në përfundim të procesit të konsultimit pasi reagimet e mbledhura nuk ndryshojnë implikimet e politikës së krijuar.

Kurse 3 (tre) aktet e konsultuara dhe të miratuara gjatë kësaj periudhe nuk janë objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45 të Rregullores së Këshillit të Ministrave.



## **2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

### **2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?**

Gjatë vitit 2023, Ministria e Mbrojtjes publikoi në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik raportet e konsultimit publik për 4 projektaktet e miratuara.

### **2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyt?**

Të gjitha raportet finale pas reflektimit të komenteve në tabelën përkatëse të raportit janë publikuar.

## **2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)**

Sa i përket projektakteve, bëjmë me dije se është respektuar me rigozitet procedura dhe kërkesat e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”:

- projektaktet janë publikuar në RENJK;
- është dhënë informacion i mjaftueshëm;
- në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit;
- është respektuar afati 20 ditor.

Për këtë arsye, Ministria e Mbrojtjes është vetëvlerësuar me pikët maksimale (8) për aktet për të cilat procesi i konsultimit publik ka përfunduar.

## **3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)**

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërshirjen e publikut në këtë proces. Ende nuk reflektohet qartësisht një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Me gjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen. Ministria e Mbrojtjes do të synojë që të ketë përfshirje aktive të shumë aktorëve në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen

duke kombinuar dhe përdorur disa metoda të procesit të konsultimit publik, si mundësia më e mirë për të arritur një rezultat efikas në të ardhmen.

Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik.